



Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5,të datës 31.10.2019, sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 të nenit 24 të Ligjit nr.06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit të dt. 12. 08.2022, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt.17.08.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS SË PALUAJTSHME ME INTERES PUBLIK

I.

Merret Vendimi për Shpalljen e pronës së paluajtshme me interes të përgjithshëm publik, me qëllim të përfitimit publik në Komunën e Deçanit, dhe ate vetëm për lokalin afarist të ish Bankos-it i cili gjendet në objektin Banesor-Afarist në ngastrën kadastrale me nr.1256-0, Z.k. Deçan, sipas matjeve në teren sipërfaqja e lokalit është 66.92m², lokali ka edhe një sipërfaqe reklamuese (vitrinë) prej 6.34 m², që në total bëjnë 73.26m², pronë e cila nevojitet kryesisht për Zyra për nevoja të Komunës, për vendosjen e shërbimeve të ndryshme të komunës.

II.

Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

V.

Vendimi u dërgohet:MAPL,Kryetarit të Komunës, Drejtorive kompetente komunale, Zyrës për Informim dhe Arhivit të Komunës së Deçanit.

01.Nr.XI-1

Deçan,dt.17.08.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ